



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

QENDRA E PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE

Nr. 166 prot.

Tiranë, më 10.04.2026

RAPORTI I PERFORMANCËS PËR VITIN 2025

Në kuadër të realizimit të raportit të performancës, për sa i përket veprimtarisë së Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, po ju paraqesim një pasqyrë gjithëpërfshirëse të punës së institucionit bazuar në përmbushjen e detyrave dhe qëllimeve mbi të cilat QPKMR ushtron aktivitetin e saj, konkretisht në parandalimin e kriminalitetit dhe të recidivizmit të të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin.

Referuar aktit në bazë të të cilit është ngritur dhe funksionon ky institucion, VKM-së nr. 314, datë 15.05.2019, “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, të ndryshuar, përcaktohet se, QPKMR organizohet në nivel qendror dhe e shtrën veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit duke bashkëpunuar me institucione të tjera për të kryer detyrat e saj funksionale në kuadër të rehabilitimit dhe riintegrit të të miturve/të rinjve në konflikt me ligjin.

Pas ndryshimeve në vendimin nr. 314, datë 15.05.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, ndryshuar me vendimin nr. 656, datë 10.10.2022, të Këshillit të Ministrave, është parashikuar se “Qendra ka një rol kyç në ushtrimin e veprimtarive parandaluese nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit që do të mirëpres të miturit e rikthyer pas përfundimit të periudhës së dënimit, kjo me qëllim rritjen e edukimit publik mbi veprimtaritë kriminale, dënimet penale si dhe shpërndarjen e informacionit mbi zgjidhje konkrete”.

Në zbatim të VKM-së nr. 149, datë 20.03.2019, “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit të të dhënave parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, të ndryshuar në vendimin nr. 655, datë

10.10.2022, të Këshillit të Ministrave, Qendra është renditur në listën e institucioneve përgjegjëse dhe përdorues për Sistemin e Integruar, pra hedhëse të dhënash dhe ka rolin e mbikqyrjes në sistem.

Gjithashtu në gurmën “d” të pikës 3, të VKM nr. 149, datë 20.03.2019, “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit të të dhënave parësore e dytësore dhe dhënësive e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, të ndryshuar është parashikuar se:

“Përveç të drejtave të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, “Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka të drejtë përdorimi, leximi, shkrimi dhe gjenerimi të të dhënave të hedhura nga përdoruesit e tjerë në sistem me qëllim grumbullimin e të dhënave, përpunimin e tyre statistikor, analizimin dhe përgatitjen e raporteve në kuadër të parandalimit e kriminalitetit dhe recidivizmit për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve realizon raporte periodike për Ministrinë e Drejtësisë për funksionimin dhe mbarëvajtjen e sistemit.”.

Shtyllat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit janë **Parandalimi, Rehabilitimi dhe Riintegrimi**, dhe në këtë kontekst pasqyrohet dhe misioni kryesor i institucionit, në “realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturit/të rinjve pas kryerjes së dënimit apo lirimit me kusht”.

Në funksion të realizimit të këtij misioni, institucioni ynë ushtron dhe veprimtari parandaluese nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese, në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit që do të mirëpresë të miturit pas përfundimit të periudhës së dënimit, apo lirimit me kusht.

Sipas përcaktimeve të gurmës “a”, të pikës II, të VKM-së nr. 314, datë 15.05.2019, “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, të ndryshuar përcaktohet se QPKMR, bashkëpunon me Shërbimin e Provës dhe/ose me administratën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur në:

- i) përgatitjen e dokumentit për lirimin me kusht, vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror/mjedisor dhe të nevojave të të miturit jashtë IEVP-së;
- ii) përgatitjen e planit individual të rishoqërizimit dhe të rehabilitimit, sipas programeve të shërbimeve;
- iii) përgatitjen e planit të menaxhimit të riskut, në rast të identifikimit të rrezikut të mesëm apo të lartë për recidivizëm;
- iv) ndjekjen, mbikëqyrjen dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike, arsimore, shëndetësore dhe situatën sociale të të miturit pas dënimit;
- v) administrimin në dosje të posaçme të kopjes së dokumentacionit individual të të miturit, të lëshuara

nga Shërbimi i Provës dhe administrata e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të miturin.

vi) Grumbullon të dhëna dhe përpunon statistika të gjeneruara nga Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe përgatit raporte e analiza për përmirësimin e gjendjes dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit apo të rinjtë në konflikt me ligjin.

I. Për sa më sipër, në kuadër të bashkëpunimit me Institutin e të Miturve Kavajë dhe Shërbimin e Provës janë marrë hapa konkrete për mbarëvajtjen e punës midis këtyre institucioneve dhe QPKMR-së, kjo si rezultat i faktit që roli dhe funksioni i Qendrës të jetë i qartë nga institucionet me të cilat do të bashkëpunohet.

➤ **Në kuadër të bashkëpunimit me administratën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur, evidentojmë se nga ana e institucionit tonë janë trajtuar 38 raste me të mitur të liruar nga Instituti i të Miturve Kavajë.**

Referuar rasteve të trajtuara nga QPKMR, më poshtë po ju përcjellim një pasqyrë të ecursisë së të miturve pas lirimit nga IM Kavaja:

1. 20 të mitur kanë vijuar ndjekjen e arsimit
2. 1 i mitur është duke ndjekur aktualisht kurs profesional
3. 15 të mitur kanë ndjekur dhe përfunduar kurse profesionale
4. 3 të mitur janë rikthyer në IM Kavajë, si recidivistë
5. 3 të mitur nuk kanë pranuar asnjë shërbim nga QPKMR

Aktualisht në Institutin e të Miturve Kavajë gjenden **30 të mitur**, nga të cilët:

6. 9 raste që janë duke vuajtur dënimin me vendim të formës së prerë
7. 21 raste me masë arresti paraburgim

Vlen të theksojmë linjën e bashkëpunimit të vendosur me administratën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të miturin në lidhje me administrimin në dosje të posaçme të kopjes së dokumentacionit individual të të miturit në konflikt me ligjin.

Në këtë kontekst dhe në vijim të një bashkëpunimi të frytshëm me administratën e Institutit të të Miturve Kavajë, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve është angazhuar vazhdimisht me nisma dhe aktivitete të ndryshme, me qëllim ofrimin e një mjedisi miqësor për të miturit që gjenden në ambientet e vuajtjes së dënimin.

➤ **Në kuadër të arritjes së qëllimit dhe misionit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si dhe ofrimin të sa më shumë mundësive për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, për periudhën Janar – Dhjetor 2025, janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit, si më**

poshtë:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, me qëllim hartimin dhe implementimin e projekteve dhe aktiviteteve të cilat përfshijnë:
zhvillimin e programeve edukative dhe trajnimeve, organizimin e punëtorive dhe seminareve me studentë dhe profesionistë, përmirësimin e metodologjive të hulumtimit dhe të mbështetjes sociale si dhe promovimin e vlerave të respektit, përgjegjësisë dhe integritit shoqëror;
2. Marrëveshje bashkëpunimi me AKPA me qëllim synimin e një angazhimi konkret për t'u ofruar të miturve që kanë pasur probleme me ligjin një shans të dytë, duke i ndihmuar të largohen nga sjelljet kundraligjshme dhe të ndërtojnë një të ardhme më të sigurt përmes arsimit, formimit profesional dhe punësimit.;
3. Marrëveshje bashkëpunimi me Organizatën Jofitmprurëse "Caritas Shqiptar" me qëllim për ofrimin e shërbimeve në kuadër të rehabilitimit dhe riintegritimit të të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin dhe për të siguruar përkrahje dhe mbështetje për këta të mitur në rehabilitimin dhe riintegritimin pas përfundimit të dënimit.

Në bashkëpunim dhe në vijim të marrëveshjes së përbashkët me CARITAS Albania, në kuadër të projektit "Shtegu i Mundësive", me fokus rehabilitimin dhe riintegritimin të miturve të cilët janë rikthyer në shoqëri pasi kanë përfunduar dënimin, janë zhvilluar takime të shumta periodike me të miturit në të gjithë territorin e vendit. Në këtë kuadër janë ofruar dhe shërbime psikologjike, mbështetje konkrete në punësim, edukim, financim për iniciativat ekonomike, si dhe konsultim i vazhdueshëm me familjen dhe komunitetin për t'i ofruar mbështetjen e nevojshme.

Marrëveshje bashkëpunimi me një biznes në Kamëz, me qëllim për ti hapur rrugë të miturve që bien në kontakt me ligjin drejt një të ardhmeje më të mirë. Ky hap i marrëveshjes së intershipit vjen si rezultat i bashkëpunimit me Caritas Shqiptar me programin Shtegu i Mundësive dhe Your Job, në kuadër të përpjekjeve tona për rehabilitimin.

➤ **Në mënyrë që procesi i parandalimit të jetë sa më gjithëpërfshirës, QPKMR ka organizuar aktivitete të ndryshme si më poshtë:**

1. Në kuadër të Javës për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit Ministria e Drejtësisë dhe QPKMR organizuan një aktivitet ndërgjegjësues në gjimnazin "Sami Frashëri.
Në këtë aktivitet sensibilizues me nxënësit e Gjimnazit "Sami Frashëri", përmes ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Qendrës për Parandalimin e Krimeve të Miturve dhe të Rinjve, u ofruan informacione të vlefshme për mbrojtjen e viktimave të krimit dhe parandalimin e krimeve

mes të rinjve. Ndërgjegjësojmë dhe angazhojmë të rinjtë për të kontribuar në një shoqëri më të sigurt dhe më të drejtë.

2. Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Drejtësinë për të Miturit 2022–2026, me fokus objektivin “Forcimi i Mekanizmave të Drejtësisë Restauruese dhe Ndërmjetësimit”, QPKMR në bashkëpunim me DHKN dhe Rotary E-Club Albania zhvilluan një sesion informues me nxënës të Gjimnazit “Samë Frashëri”, me temë “Ndërtimi i kulturës së dialogut tek të rinjtë përmes fuqisë së ndërmjetësimit”. Gjatë aktivitetit, nxënësit u angazhuan në diskutime të hapura, ushtrime praktike dhe skenarë ndërveprues që ndihmuan në kuptimin e rolit të dialogut të shëndetshëm dhe ndërmjetësimit në menaxhimin e situatave konfliktuale.

Aktiviteti kishte si qëllim të mbështesë të rinjtë në zhvillimin e aftësive të komunikimit, dëgjimit aktiv dhe bashkëpunimit, duke promovuar zgjidhje paqësore dhe marrëdhënie më pozitive brenda komunitetit shkollor.

3. QPKMR në bashkëpunim me UNICEF - Albania organizoi një aktivitet me të rinjtë e Cërrikut, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur, për t’i informuar mbi Drejtësinë Penale për të Mitur – mbi të drejtat e tyre përgjegjësitë dhe mbrojtjen që ligji ofron për ta. Ky aktivitet u zhvillua në formën e një diskutimi të hapur, me pjesëmarrje aktive dhe plot pyetje që treguan sa të interesuar dhe të angazhuar janë të rinjtë për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë dhe më të sigurt.
4. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ASDO në bashkëpunim me Shërbimin Social të Bashkisë Pogradec, Qendrën e Parandalimit të Krimin të të Miturve dhe UNICEF Albania, organizoi një aktivitet të veçantë pranë Qendrës Multifunktionale “BiblioTech”.

Më shumë se 50 fëmijë dhe të rinj morën pjesë në diskutime të hapura mbi të drejtat e fëmijëve, rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve me aftësi ndryshe, dhe ndikimin që diskriminimi dhe përjashtimi social ka në jetën e bashkëmoshatarëve të tyre.

Përmes lojërave interaktive, pyetjeve reflektuese dhe punës në grup, të rinjtë patën mundësi të shprehin mendimet e tyre lirshëm dhe të ndihen të dëgjuar.

Në përmbyllje të aktivitetit, pjesëmarrësit u ftuan të reflektojnë personalisht dhe të bëjnë një premtim simbolik: që secili të reagojë përballë padrejtësisë, të ngrejë zërin kur dikush përjashtohet, dhe të kontribuojë për një komunitet më gjithëpërfshirës dhe të drejtë për të gjithë fëmijët.

Ky aktivitet është pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për të ndërtuar një shoqëri më të ndërgjegjshme dhe të barabartë, ku asnjë fëmijë të mos mbetet pas.

5. Në bashkëpunim me Klea Huta Academy dhe me mbështetjen e Ambasadës Franceze u organizua aktiviteti Forum Teatër “My Voice” me qëllim edukimin e të rinjve për pasojat e dhunës dhe veprave

penale.

Aktiviteti u përshëndet nga pjesëmarrës dhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ambasadës Franceze, Policisë së Shtetit, prindër, mësues dhe të rinj.

Publiku tregoi angazhim të lartë, duke kontribuar aktivisht në situatat e paraqitura në skenë.

Ndërhyrjet dhe reagimet e tyre sollën diskutime të vlefshme, shkëmbim mendimesh dhe propozime konkrete mbi mënyrat e parandalimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës. Ky ndërveprim i drejtpërdrejtë e shndërroi aktivitetin në një platformë të rëndësishme reflektimi dhe edukimi qytetar.

Një prodhim i Klea Huta Academy, i realizuar me profesionalizëm dhe përkushtim për të sjellë mesazhe të forta dhe të domosdoshme për brezin e ri.

6. Në bashkëpunim me AKR dhe Universitetin Mesdhetar u zhvillua aktiviteti mbi bullizmin fizik dhe digjital dhe menaxhimi i identitetit online.

Gjatë aktivitetit u diskutuan format e bullizmit, pasojat e tij në shëndetin mendor të të rinjve, si edhe rëndësia e ndërtimit të një identiteti të shëndetshëm online, duke promovuar përdorimin e sigurt dhe të përgjegjshëm të hapësirave digjitale.

7. Në kuadër të muajit “Tetori Rozë”, Qendra për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) mbështet fushatat e ndërgjegjësimit për rëndësinë e kujdesit ndaj shëndetit dhe kontrollit të rregullt.

Tetori Rozë kujton se kujdesi ndaj vetes dhe mbështetja ndaj njëri-tjetrit janë shprehje e forcës dhe solidaritetit në shoqëri.

8. Gjithashtu, në vijim të marrëveshjes së përbashkët me Kryetaren e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, me nisjen e shkollës, u miratua Plan i Ri i Punës. Ky plan u nis me programin për “Ndërmjetësit Junior”, duke futur si pjesë të edukimit ligjor mbi drejtësinë për të mitur edhe hapat konkretë se si adoleshentët të ndërmjetësojnë me dialog konfliktet mes tyre pa qenë e nevojshme që ato të eskalojnë në dhunë apo veprime të kundraligjshme.
Si dhe u hartëzuan rastet e të miturve që po ndiqen me ndërmjetësim në zbatim të një drejtësie restauruese në vend të asaj ndëshkuese.

- **TAKIME TË REALIZUARA DHE MARRJE PJESË NË KONFERENCA NË NIVEL NDËRKOMBËTAR/RAJONAL**

Gjatë vitit 2025, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka realizuar takime dhe ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare/rajonale si më poshtë vijon:

- **QPKMR mori pjesë në Konferencën Rajonale për ndalimin e dhunës ndaj fëmijëve në Bukuresht, duke ndarë përvojat dhe përpjekjet për forcimin e drejtësisë për të mitur dhe mbrojtjen e fëmijëve;**

Në Konferencën Rajonale për Ndalimin e Dhunës ndaj Fëmijëve, organizuar nga Ministria e Punës, Familjes dhe Rinisë së Rumanisë, në bashkëpunim me UNICEF dhe përfaqësuesin e Sekretariatit të Përgjithshëm të OKB-së për mbrojtjen e fëmijëve, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) u përfaqësua në delegacionin shqiptar nga Drejtoresha e Qendrës, Znj. Klaudia Hasanllari.

Së bashku me Kryetaren e ASHDMF, Znj. Alma Tandili, Përfaqësuesin e Zyrës së UNICEF Shqipëri, Z. Murat Sahin dhe Znj. Emira Shkurti, specialiste për të drejtat e fëmijëve, delegacioni prezantoi zhvillimet në Shqipëri për mbrojtjen e fëmijëve dhe sfidat.

Në panelin “Roli i Reformimit të Drejtësisë në ndalimin e dhunës ndaj fëmijëve”, Znj. Hasanllari ndau praktikën e Shqipërisë dhe zhvillimet sa i takon krijimit të Kodit të Ri të Drejtësisë për të Mitur, zhvillimin e drejtësisë restauruese, qasjen multi-disiplinare dhe vështirësitë e sfidat në implementim.

Bukuresht, Tetor 2025.

- **QPKMR mori pjesë në mbledhjen e Komisionit të Sigurisë të OSCE në Vienë, me ftesë të OSCE dhe me autorizimin e Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim prezantimin e studimit për ndikimin e pavarësisë financiare në parandalimin e krimit tek të miturit dhe të rinjtë.**

Në mbledhje u diskutua se si institucionet mund të përfshijnë edukimin dhe fuqizimin financiar në programet parandaluese dhe riintegruese, qoftë për parandalimin primar, qoftë për të shmangur rikthimin e tyre në krim.

Vienë, Prill 2025.

- **QPKMR mori pjesë në zhvillimin e Konferencës Rajonale për Rikonceptimin e Drejtësisë për të Mitur në Rajon dhe Zbatimin e Drejtësisë Restauruese organizuar nga UNICEF dhe Qeveria Turke.**

Në panelin drejtuar nga Anëtari i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve pranë Kombeve të Bashkuara, Z. Benoit Van Keirsbilck, Drejtoresha e Qendrës, Znj. Klaudia Hasanllari prezantoi të gjithë panoramën legislative dhe institucionale të Shqipërisë për zbatimin e drejtësisë për të mitur, arritjet, sfidat dhe

objektivat për të ardhmen.

➤ **Në vijim të promovimit të punës dhe rolit të institucionit me qëllim jo vetëm të realizimit të detyrave funksionale por edhe të intensifikimit të prezencës së QPKMR-së në veprimatritë të cilat përfshijnë aktivitete në fushën e drejtësisë penale për të mitur, janë realizuar takime të ndryshme me aktorët e mëposhtëm:**

- **Takim informues i zhvilluar në Qendrën TOK me UNICEF për parandalimin e krimit të rinjtë.**

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, ka realizuar një takim frymëzues me adoleshentë, për informimin dhe parandalimin e krimeve tek të miturit dhe të rinjtë, pranë Qendrës së sapokrijuar “TOK”, në kuadrin e programit “BE për Kujdesin Social”.

Kjo Qendër ofron për herë të parë shërbime sociale komunitare në Bashkinë Kavajë, ngritur me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian dhe zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania.

Kjo veprimtari ishte pjesë e një bashkëpunimi mes Qendrës për Parandalimin e Kriminalitetit të të Miturve dhe të Rinjve, UNICEF Albania dhe Qendrës Burimore të Alternativave të Zhvillimit për krijimin e një shoqërie më të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, ku të Rinjtë jo vetëm informohen, por mbështeten e fuqizohen për të ndërtuar të ardhmen e tyre larg rreziqeve.

- **Takim me aktorët e vijës së parë në Sarandë për forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së të miturve.**

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, mori pjesë në takim ndërinstitucional në Sarandë me aktorët e vijës së parë për drejtësinë penale për të mitur, ku u trajtuan sfidat, bashkëpunimi dhe përmirësimi i mekanizmave të referimit dhe ndërhyrjes për mbrojtjen e të miturve.

- **Takim me të rinjtë për të mësuar për të drejtat dhe drejtësinë miqësore me mbështetjen e UNICEF dhe QPKMR.**

Vazhdon puna për promovimin e U-Report për të fuqizuar zërin e të rinjve në vendimarrje.

QPKMR ndau me të rinjtë punën e palodhur të stafit të Qendrës që udhëton qytet më qytet për të ofruar edukim ligjor në të gjitha institucionet arsimore dhe për të mbështetur ri-integrimin në shoqëri të fëmijëve në konflikt me ligjin. Kjo nismë e përbashkët e UNICEF Albania, Qendrës për Hapje dhe Dialog dhe QPKMR-së, shërben për të informuar fëmijët me të drejtat që ata kanë në rast se bien në konflikt me ligjin

apo janë viktima a dëshmitarë të krimit.

- **Takim së bashku me GTN dhe Caritas-in Shqiptar zhvilluar në qytetin e Vlorës, pranë një të mituri që po hedh hapat e parë drejt riintegrit në komunitet, pas përfundimit të dënimit penal.**

Qëllimi i këtij takimi ishte ofrimi i mbështetjes të gjithanshme për rehabilitim dhe përfshirje sociale, përmes edukimit, kurseve profesionale, përkrahjes psiko-sociale dhe mundësive për punësim.

- **Takim me delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri.**

QPKMR zhvilloi një takim me përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri, për të diskutuar mbi bashkëpunimin në fushën e drejtësisë për të mitur dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve.

Gjatë takimit u shkëmbyen ide mbi nxitjen e qasjeve parandaluese, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në përputhje me standardet europiane.

- **QPKMR, synon përfshirjen sa më efektive në komunitet të të miturve autorë të veprave penale nëpërmjet programeve rehabilituese. Në kuadër të rehabilitimit, janë organizuar disa tryeza të rrumbullakëta në bashkëpunim me institucionet bashkërenduese si më poshtë:**

- Në kuadër të riintegrit dhe rehabilitimit e të miturve në konflikt me ligjin Qendra për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) organizoi një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrjen e institucioneve kyçe si ASHDMF, AKPA, dhe Drejtoria e Shërbimit Social Tiranë.
Gjatë diskutimeve u trajtuan sfidat dhe mundësitë për mbështetjen e të miturve në konflikt me ligjin, me synimin për t'u ofruar atyre një shans për riintegrim të suksesshëm dhe zhvillim personal.
- Pjesëmarrje në tryezën e organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit për rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve me fokus diskutimin mbi përmirësimin e praktikave dhe politikave për trajtimin e personave të mitur dhe të rinj në konflikt me ligjin.
Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues nga Avokati i Popullit, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- Pjesëmarrje në tryezën ndër-institucionale me ftesë të AKR, ku u zhvillua një diskutim i gjerë mbi promovimin e shëndetit mendor të Gjenerata Z, duke u ndalur te sfidat aktuale që përballen të rinjtë, roli i institucioneve dhe rëndësia e bashkëpunimit ndër-institucional.
U theksua nevoja për politika parandaluese, programe ndërgjegjësuese dhe shërbime mbështetëse të qëndrueshme që synojnë përmirësimin e mirëqenies mendore dhe sociale të të rinjve.

➤ **Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të punonjësve, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, Qendra ka marrë pjesë në disa trajnime dhe seminare si më poshtë:**

- QPKMR mori pjesë në workshopin me temë "Parandalimi i kriminalitetit tek të miturit përmes sfidash dhe perspektivash:
Aftësi e shprehi të edukimit me bashkëmoshatarë, të organizuar nga United Rights Foundation, në bashkëpunim me studentë të Fakultetit të Drejtësisë.
Workshopi u moderua nga Znj. Klaudia Hasanllari, drejtoreshë e QPKMR dhe eksperte e kriminologjisë dhe Znj. Esjurda Tallushi, eksperte e sjelljes e çështjeve sociale në URF.
Ky workshop solli në vëmendje modelin e drejtësisë restauruese për të mitur, një qasje që vendos në qendër mirëqenien, rehabilitimin dhe rikthimin e balancës sociale.
- Leksion i hapur me studentët e Kolegjit Universitar të Biznesit, mbi kriminalitetin e të miturve, i zhvilluar nga drejtoresha e QPKMR. U diskutua mbi analiza konkrete, sfidat aktuale në fushën e rehabilitimit, tipologjitë më të shpeshta, faktorët kriminogjenë dhe statistika të rëndësishme që flasin vetë.
- QPKMR mori pjesë në trajnimin ndër-institucional multidisiplinar e zhvilluar nga URF në bashkëpunim me QPKMR me temë: "Motivimi i te miturve e te rinjve në konflikt me ligjin mbi sjelljet pro-sociale mbështetëse për re-integrim në shoqëri". Pjesëmarrës ishin 16 profesionistë si psikologë, punonjës social, specialistë të shërbimit të provës, juristë dhe gazetarë. Trajnimi u realizua nga ekspertja e sjelljes dhe çështjeve sociale Znj. Esjurda Tallushi dhe u shoqërua me certifikatë pjesëmarrjeje.
- U zhvillua trajnimi dy ditor "Training of Trainers" me përshëndetjet e Zëvendësministres së Drejtësisë, Znj. Elona Hoxha, dhe Ambasadores së Francës në Shqipëri, Znj. Catherine Suard, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh për zhvillimin e drejtësisë për të mitur.
Në qendër të takimit ishte ngritja e kapaciteteve të Institutit për Edukimin dhe Rehabilitimin e të Miturve, përmes krijimit të rrjetit të parë kombëtar të trajnerëve, një hap thelbësor drejt standardeve bashkëkohore dhe praktikave më të mira evropiane.
Workshop-i po udhëhiqet nga ekspertët e ENPJJ: Charline Olivier dhe Sylvie Le Blavec, të cilat po ndajnë përvojën dhe metodologjitë franceze në formimin e trajnerëve.
Pjesëmarrëse ishin gjithë institucionet e Drejtësisë Penale për të Mitur.
- QPKMR mori pjesë në Dialogun Strategjik Vjetor të organizuar nga UNICEF - Albania, së bashku me përfaqësues nga institucionet shtetërore dhe anëtarët e Bordit Këshillimor të Adoleshentëve, për të vlerësuar progresin e vitit 2025, për të përcaktuar prioritetet për vitin 2026 dhe për të hedhur bazat e Programit të ri të Vendit 2027–2031.

II. Në funksion të rolit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) si një institucion i cili grumbullon të dhëna, bën përpunimin e tyre statistikor, analizimin dhe përgatitjen e raporteve në kuadër të parandalimit të kriminalitetit dhe recidivizmit për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, dhe me predispozitën që sistemi të jetë sa më efektiv është vijuar me monitorimin e tij dhe mbajtjen e kontakteve me personat përgjegjës të institucioneve përdoruese, me qëllim popullimin me të dhënat që gjeneron çdo institucion sipas fushës së veprimtarisë së tij.

Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve në datë 5 nëntor 2025 organizoi takimin në kuadër të krijimit të një lidhjeje automatike midis Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve (CMS) të Prokurorisë dhe Sistemit të Integruar të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, me pjesëmarrjen e UNOPS, përfaqësuesve nga Ministria e Drejtësisë, AKSHI-t pranë Ministrisë së Drejtësisë, konsulentit të UNICEF-it dhe përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse përdoruese të këtij sistemi. Ky takim u realizua në kuadër të projektit për implementimin e një sistemi menaxhimi çështjesh pranë Prokurorisë së Përgjithshme, projekt i cili pritet të realizohet nga UNOPS në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme dhe duke qenë në fazën fillestare të diskutohej mundësia e integritimit në mënyrë automatike me Sistemin e Integruar apo edhe me sistemet e institucioneve të tjera që janë në fazë implementimi siç është dhë sistemi ICMIS i Gjykatave, me qëllim lehtësimin e proceseve të punës dhe për të shmangur problematika si dublikimi i të dhënave apo mungesa e disa çështjeve në Sistemin e Integruar.

Për sa i takon mbarëvajtjes dhe funksionimit të Sistemit të Integruar ju informojmë se Sistemi i Integruar ka rifilluar funksionimin më datë 14 prill 2025. Nga data 31 tetor 2024 deri në rifillimin e funksionimit, Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ka qenë jashtë funksionimit.

Gjithashtu, Sistemi i Integruar ka qenë jashtë funksionit edhe që prej datës 12 dhjetor 2025, ku pas komunikimeve me përfaqësuesin e AKSHI-t në Ministrinë e Drejtësisë, është rivënë përsëri në funksion më datë 22 dhjetor 2025.

Aktualisht, Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur është funksional dhe po vijon procesi i hedhjes së të dhënave nga institucionet përdoruese me përjashtim të Gjykatave dhe QPKMR të Sistemit të Integruar edhe pse në shifra shumë të ulëta.

Mungesa e mirëmbajtjes së sistemit mbetet një sfidë e madhe, e cila ndikon negativisht në performancën dhe efektivitetin e tij. Kjo situatë krijon vështirësi për përdoruesit e institucioneve, duke sjellë vështirësi në hedhjen e të dhënave dhe moskoherencë në shifrat statistikore të cilat analizohen nga ana jonë.

Gjithashtu u identifikua nevoja për përmirësimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Me predispozitën që Sistemi i Integruar të jetë sa më eficient, QPKMR ka vijuar me monitorimin e Sistemit të Integruar dhe mbajtjen e kontakteve me personat përgjegjës të institucioneve përdorues, duke përcjellë më pas çdo problematikë për zgjidhje pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Situata e hedhjes së të dhënave/popullimit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur nga institucionet kompetente për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

Situata e hedhjes së të dhënave në sistem nga institucionet përgjegjëse (Policia, Prokurori, Shërbim Prove, IEVP për të mitur Kavajë, Gjykatë Shkallës Parë, Gjykatë Apeli, Gjykata e Lartë) rezulton e pasqyruar në një panoramë të përgjithshme si më poshtë:

- Në sesionin “**Të Mitur**”, nga ku gjenerohet raporti për të gjitha rastet e hedhura në Sistemin e Integruar nga institucionet përdoruese për periudhën Janar - Dhjetor 2025 rezultojnë **1616 raste** dhe në total rezultojnë që janë hedhur **6956 raste**.

- **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, drejtoritë vendore të policisë dhe/ose drejtoritë vendore për kufirin dhe migracionin - 1432 raste**

Në total janë hedhur **5829 raste**

- **Zyrat/seksionet e Prokurorisë në nivel rrethi dhe apeli, që hetojnë çështje penale me të mitur; - 162 raste**

Në total janë hedhur **1690 raste**

- **Gjykata e Lartë - 0 raste**

- **Gjykatat/seksionet në nivel rrethi dhe apeli, që gjykojnë çështje penale me të mitur; - 0 raste**

- **Zyrat Territoriale të Shërbimit të Provës që trajtojnë rastet e të miturve me masë shmangieje ose masë alternative të dënimit me burgim, si dhe hartimi i Raportit të Vlerësimit Individual për të miturin në konflikt me ligjin. - 320 raste**

Në total janë hedhur **1038 raste**

- **Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, ku ndodhen të miturit e dënuar ose të paraburgosur; - 51 raste**

Në total janë hedhur **128 raste**

- Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) - **0 raste**


Referuar të dhënave të hedhura nga përdoruesit e Sistemit të Integruar përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, situata rezulton si më poshtë vijon:

1. **Policia** – rezulton me 1432 raste të hedhura gjithsej në periudhën Janar – Dhjetor 2025, ndërsa Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër rezulton pa të dhëna në sistem.

Të dhënat e hedhura në Sistemin e Integruar sipas Drejtorive Vendore të Policisë rezultojnë si më poshtë:

- DVP Kukës – **97 raste** (Total raste të hedhura **306 raste**)
- DVP Berat – **15 raste** (Total raste të hedhura **246 raste**)
- DVP Korçë – **360 raste** (Total raste të hedhura **858 raste**)
- DVP Elbasan – **93 raste** (Total raste të hedhura **187 raste**)
- DVP Gjirokastrë – **124 raste** (Total raste të hedhura **367 raste**)
- DVP Fier – **383 raste** (Total raste të hedhura **954 raste**)
- DVP Lezhë – **0 raste** (Total raste të hedhura **312 raste**)
- DVP Vlorë – **240 raste** (Total raste të hedhura **511 raste**)
- DVP Tiranë – **33 raste** (Total raste të hedhura **1815 raste**)
- DVP Durrës – **12 raste** (Total raste të hedhura **118 raste**)
- DVP Dibër - **75 raste** (Total raste të hedhura **154 raste**)

Situata e pasqyruar në formë grafike si më poshtë:




2. **IEVP për të mitur Kavajë** – rezulton të jenë hedhur gjithsej në Sistemin e Integruar për periudhën Janar – Dhjetor 2025, **51 raste**.

Në total janë të hedhura në Sistemin e Integruar **128 raste** nga të cilat:

- **107 raste** me masë arresti paraburgim
- **21 raste** që vuajnë dënim me burg.

Duke qenë se kolona që tregon datën e regjistrimit të rastit në shumicën e herëve është e paplotësuar nuk mund të kemi një pasqyrë të qartë të rasteve të hedhura për këtë periudhë, por është bërë një analizë krahasuese me numrin e rasteve të pasqyruara në raportet aktualë dhe atyre të kryera më përpara.

Situata e pasqyruar në formë grafike si më poshtë:



3. **Shërbimi i Provës** - rezulton të jenë hedhur gjithsej në Sistemin e Integruar për masat alternative të dënimit me burg për periudhën Janar – Dhjetor 2025, **39 raste**.

Në total janë të hedhura në Sistemin e Integruar **242 raste**.


Situata e të dhënave të hedhura në Sistemin e Integruar është e pasqyruar si më poshtë:

- **2 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Tiranë. (Në total janë hedhur **69 raste**)
- **4 raste** i hedhur nga Dega Territoriale Korçë. (Në total janë hedhur **25 raste**)

- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Vlorë. (Në total janë hedhur **12 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Shkodër. (Në total janë hedhur **7 raste**)
- **0 rast** i hedhur nga Dega Territoriale Lushnje. (Në total është hedhur **1 rast**)
- **7 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Elbasan. (Në total janë hedhur **37 raste**)
- **0 raste** të hedhur nga Dega Territoriale Berat. (Në total është hedhur **1 rast**)
- **2 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Pogradec. (Në total janë hedhur **5 raste**)
- **2 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Lezhë. (Në total janë hedhur **12 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Pukë. (Në total është hedhur **1 rast**)
- **0 rast** i hedhur nga Dega Territoriale Kukës. (Në total janë hedhur **11 raste**)
- **18 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Fier. (Në total janë hedhur **38 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Krujë. (Në total janë hedhur **2 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Përmet. (Në total janë hedhur **2 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Kavajë. (Në total është hedhur **1 rast**)
- **4 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Kurbin. (Në total janë hedhur **4 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Mat. (Nuk ka raste të hedhura)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Durrës. (Në total janë hedhur **14 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Sarandë. (Nuk ka raste të hedhura)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Dibër. (Nuk ka raste të hedhura)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Gjirokastër. (Nuk ka raste të hedhura)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Tropojë. (Nuk ka raste të hedhura)

Situata e pasqyruar në mënyrë grafike është si më poshtë:

RASTE TË HEDHURA NGA SHËRBIMI I PROVËS NË SISTEMIN E INTEGRUAR PËR PERIUdhËN JANAR - DHJETOR 2025



➤ **Shërbimi i Provës ku rastet me masa alternative për shmangien nga ndjekja penale rezultojnë me 6 raste të hedhura për periudhën Janar – Dhjetor 2025.**

- Rastet me masa alternative për shmangien nga ndjekja penale rezultojnë **16 raste të hedhura në total në sistem nga Degët Territoriale të Shërbimit të Provës dhe konkretisht:**

- **0 raste të hedhura nga Dega Territoriale Shkodër. (Në total janë hedhur 3 raste)**
- **0 rast i hedhur nga Dega Territoriale Vlorë. (Në total janë hedhur 2 raste)**
- **0 raste të hedhur nga Dega Territoriale Korçë. (Në total janë hedhur 4 raste)**
- **6 rast i hedhur nga Dega Territoriale Fier. (Në total është hedhur 7 rast)**


➤ **Shërbimi i Provës rastet me lirim me kusht – nuk është hedhur asnjë e dhënë.**

➤ **Shërbimi i Provës, Raporti Individual i Vlerësimit për të miturin në konflikt me ligjin – rezultojnë 275 raste të hedhura për periudhën Janar – Dhjetor 2025 në Sistemin e Integruar dhe në total janë 780 raste të hedhura nga degët territoriale të Shërbimit të Provës, nga të cilat:**

- **4 raste të hedhura nga Dega Territoriale Pukë. (Në total janë hedhur 8 raste)**
- **0 raste të hedhura nga Dega Territoriale Shkodër. (Në total janë hedhur 40 raste)**
- **0 raste të hedhur nga Dega Territoriale Sarandë. (Në total janë hedhur 25 raste)**
- **3 raste të hedhura nga Dega Territoriale Pogradec. (Në total janë hedhur 25 raste)**
- **12 raste të hedhura nga Dega Territoriale Korçë. (Në total janë hedhur 28 raste)**
- **31 raste të hedhura nga Dega Territoriale Fier. (Në total janë hedhur 106 raste)**
- **48 raste të hedhura nga Dega Territoriale Kukës. (Në total janë hedhur 81 raste)**
- **11 raste të hedhura nga Dega Territoriale Vlorë. (Në total janë hedhur 14 raste)**
- **0 raste të hedhura nga Dega Territoriale Berat. (Në total është hedhur 1 rast)**
- **9 raste të hedhura nga Dega Territoriale Tiranë. (Në total janë hedhur 64 raste)**
- **7 raste të hedhura nga Dega Territoriale Lezhë. (Në total janë hedhur 82 raste)**
- **10 raste të hedhura nga Dega Territoriale Lushnje. (Në total janë hedhur 27 raste)**
- **0 raste të hedhura nga Dega Territoriale Krujë. (Në total janë hedhur 23 raste)**
- **3 rast i hedhur nga Dega Territoriale Elbasan. (Në total janë hedhur 11 raste)**
- **0 raste të hedhura nga Dega Territoriale Kavajë. (Në total janë hedhur 6 raste)**
- **0 raste të hedhura nga Dega Territoriale Durrës. (Në total janë hedhur 16 raste)**
- **0 raste të hedhura nga Dega Territoriale Përmet. (Në total janë hedhur 4 raste)**
- **0 rast i hedhur nga Dega Territoriale Dibër. (Në total është hedhur 1 rast)**

Situata e pasqyruar në mënyrë grafike është si më poshtë:

NUMRI I RASTEVE TË HEDHURA SHËRBIMI I PROVËS - RVI NË SISTEMIN E INTEGRUAR PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2025




4. Prokuroria rezulton me **162 raste** të hedhura për periudhën Janar – Dhjetor 2025, ndërsa në total rezultojnë të hedhura në Sistemin e Integruar **1690 raste** nga të cilat:

- **23 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Fier. (Në total janë hedhur **158 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Lezhë. (Në total janë hedhur **107 raste**)
- **21 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Dibër. (Në total janë hedhur **66 raste**)
- **0 raste** i hedhur nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Krujë. (Në total janë hedhur **44 raste**)
- **44 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Kukës. (Në total janë hedhur **128 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Durrës. (Në total janë hedhur **98 raste**)
- **0 raste** të hedhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës. (Në total janë hedhur **27 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Pogradec. (Në total janë hedhur **23 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Mat. (Në total janë hedhur **66 raste**)
- **8 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Berat. (Në total janë hedhur **131 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Tropojë. (Në total janë hedhur **17 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Korçë. (Në total janë hedhur **63 raste**)

- **36 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Elbasan. (Në total janë hedhur **209 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Pukë. (Në total janë hedhur **2 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Gjirokastrë. (Në total janë hedhur **5 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Kavajë. (Në total janë hedhur **27 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Përmet. (Në total janë hedhur **8 raste**)
- **30 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Sarandë. (Në total janë hedhur **143 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Lushnje. (Në total janë hedhur **58 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Tiranë. (Në total janë hedhur **174 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Shkodër. (Në total janë hedhur **41 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Vlorë. (Në total janë hedhur **73 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. (Në total janë hedhur **2 raste**)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Kurbin. (Në total janë hedhur **18 raste**)
- **0 rast** i hedhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. (Në total është hedhur **1 rast**)
- **0 rast** i hedhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. (Në total është hedhur **1 rast**)

Situata e pasqyruar në mënyrë grafike është si më poshtë:

NUMRI I RASTEVE TË HEDHURA NGA PROKURORIA NË SISTEMIN E INTEGRUAR PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025



5. **Gjykata** (Shkalla I, Apeli, E Lartë) – rezulton se nuk ka asnjë të dhënë të hedhur në Sistemin e Integruar, ku shumë gjykata kanë referuar problematika gjatë hedhjes së të dhënave në sistem, problematika të cilat janë adresuar për zgjidhje pranë përfaqësuesit të AKSHI-t në MD.

Problematika

Duke qenë se sistemi është duke funksionuar, pra po vijohet me hedhjen e të dhënave nga institucionet përkatëse dhe ne si subjekt vëzhgues jemi në mbikëqyrje të vazhdueshme të tij, janë evidentuar disa problematika dhe konkretisht:

- Popullimi shumë i ulët nga institucionet përdoruese, të cilat rezultojnë të kenë hedhur një numër të vogël rastesh në sistem, nisur dhe nga fakti që sistemi nuk ka punuar për periudha të gjata kohe apo dhe mungesa e shërbimit të mirëmbajtjes.
- **Drejtoritë Vendore të Policisë** evidentohet se nuk hedhin të dhëna në lidhje me arsyen e regjistrimit fillestar (dëshmitar, viktime, autor i veprës penale); statusin përfundimtar (si është proceduar me rastin).
- **Gjykatat** nuk kanë hedhur të dhëna, sipas Udhëzimit të KLGJ nr. 427, datë 14.10.2022 “*Për përdorimin dhe hedhjen e të dhënave në Sistemin e Integruar të të Dhënave Të Drejtësisë Penale për të Mitur, nga Gjykatat e Republikës së Shqipërisë*”, referuar dhe problematikave që kanë pasur.
- **IEVP** në raportin që gjenerohet nga Sistemi i Integruar nuk ka të përcaktuar datën e regjistrimit, datën e lirimit, kohëzgjatjen e vuajtjes se dënimit/paraburgimit nga i mituri, moshën, statusin familjar.
- **Shërbimi i Provës** në raportin që gjenerohet nga Sistemi i Integruar, nuk ka të hedhur përfundimin e ekzekutimit. I papërcaktuar në disa raste është dhe statusi i çështjes, apo në raportin që gjenerohet nga Sistemi i Integruar për shmangiet nga ndjekja penale në disa raste të hedhura gjithsej nuk paraqitet e hedhur moshën e të miturit.
- **Prokuroria** në disa raste nuk ka të hedhura statusin përfundimtar dhe arsyen përkatëse, si dhe nuk ka kolonë për përcaktimin e gjinisë të të miturit.
- **QPKMR** nuk ka hedhur akoma raste në sistem dhe pse është krijuar moduli për hedhjen e të dhënave nuk është implementuar në sistem nga AKSHI.

Ky zhvillim do t'i mundësojë stafit të QPKMR hedhjen e të dhënave në sistem, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

- Kryesisht tek të gjitha institucionet ka mangësi në plotësimin e të dhënave sipas indikatorëve përkatës, gjë e cila sjell mospasjen e statistikave të sakta. Nga komunikimet me institucionet përkatëse janë referuar problematika/vështirësi në hedhjen e të dhënave apo fshirja e informacionit të hedhur pasi verifikohet më pas.
- Në seksionin “**Të Mitur**” – në raportin që gjenerohet nga Sistemi i Integruar, nuk ka të përcaktuar indikatorin e datës së hedhjes së rastit, nuk ka indikator edhe për gjininë, statusin e rastit.

Në vijim të sa më sipër, QPKMR ka përcjellë në mënyrë të vazhdueshme pranë Ministrisë së Drejtësisë çdo problematikë të hasur nga përdoruesit e sistemit të institucioneve përgjegjëse, apo dhe çdo nevojë, mendim apo sugjerim të identifikuar nga ana jonë me qëllim mbarëvajtjen dhe funksionimin sa më efektiv të sistemit dhe realizimin e detyrave tona funksionale.

III. MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar bëhet bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

- Fonde te ardhura nga Ministria e Drejtësisë, për llogaritë ekonomike 600,601 dhe 602 janë si më poshtë, sipas shkresës nr. 912 prot ,datë 11.02.2025 nga Ministria e Drejtësisë :
 - Paga 24,000,000 lekë
 - Sigurime shoq. dhe shend. 5,000,000 lekë
 - Shpenzime operative 6,000,000 lekë
 - Fond i vecantë 100,000 lekë

Sipas shkresës nr. 1060/2 prot, datë 17.04.2025 nga Ministria e Drejtësisë ka ardhur fondi i investimeve prej 300,000 lekë i ndarë në zërat : Blerje pajisje elektronike në shumën 150,000 lekë dhe zëri Blerje Pajisje zyre në shumën 150,000 lekë.. Në datën 18.07.2025 me shkresën nr. 3129/3 prot nga Ministria e Drejtësisë , fondi prej 150,000 lekë në zërin pajisje zyre ka kaluar në zërin pajisje elektronike për shkak të nevojave më të mëdha. Në llogarinë e fondit special është hedhur shuma 100,000 lekë sipas shkresës nr. 1059/3, prot, 12.03.2025 dhe shuma prej 24,000 lekë e cila është pakësuar nga llogaria ekonomike 602 dhe është shtuar në llogarinë ekonomike 606, sipas shkresës shkresë nr. 1060/2 prot, datë 17.04.2025 nga Ministria e Drejtësisë. Llogaria ekonomike 602 (shpenzime operative) bëhet 5,976,000 lekë, dhe nga akti normativ nr. 18059/51 dt 29.12.2025 nga Ministria e Financave shuma pakësohet me 2,000,000 lekë dhe shkon në vlerën 3,976,000 lekë.”.

Përmbledhese e fondeve përfundimtare të alokuara në tabelën më poshtë sipas rishikimeve të buxhetit në fund të vitit :

Nr	Emertimi	Shuma
1.	Fondi i pagave	24,000,000
2.	Fondi për sig shoqërore dhe shëndetësore	5,000,000
3.	Fondi për shpenzime operative me kod 91401AD	3,976,000
4.	Fondi special 606	124,000
5.	Investime	300,000
	Totali	33,400,000

Realizimi i fondeve për vitin janar –dhjetor 2025.

Nr	Emertimi	Plani vjetor	Fakti 12-mujor	% e realizimit
1.	Shpenzime për paga	24,000,000	21,489,986	90
2.	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	5,000,000	3,590,139	72
3.	Shpenzime operative	3,976,000	3,444,694	87
4.	Fond special	124,000	21,733	17
5.	Investime	300,000	192,500	65
	Totali	33,400,000	28,739,052	86%

1. PERFORMANCA ANALITIKE E BUXHETIT

SHPENZIME PËR PAGA DHE SIGURIME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Buxheti i alokuar për paga dhe sigurime shoqërore është 29,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 87%.

Mosrealizimi i plotë i fondit të pagave lidhet me:

- punonjës me leje lindjeje
- largime nga puna të punonjësve me kontratë

SHPENZIMET OPERATIVE

Për shpenzimet operative fondi i alokuar është 5,976,000 lekë. Sipas regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike 2025, jepet realizimi zë më zë i shpenzimeve (llog 602) në tabelën më poshtë: dhe fondi 3,976,000 ka mbetur pas aktit normative dhe zërat në regjistër nuk janë ndryshuar:

Nr	Emertimi I shpenzimeve	Buxheti	Realizimi	%
1	Kancelari	156,000	50,136	
2	Materiale Pastrimi dhe dizinfektimi	180,000	89,880	
3	Materiale zyre tonera dhe bojra printer	300,000	41,880	
4	Furnizime me materiale te tjera zyre	36,000	35,580	
5	Shpenzime printimi	240,000		
6	Shërbime te tjera materiale promocionale	120,000	119,664	
7	Shpenzime uji	60,000	6,144	
8	Shpenzime posta	42,000	7,240	
9	Sherbime te tjera	198,000	198,000	
10	Mirembajtje faqe web	300,000	144,000	
11	Karburant dhe lubrifikant	1,200,000	1,056,888	
12	Pjese kembimi (goma dhe bateri)	600,000	477,120	
13	Taksa siguracion	46,000	46,083	
14	Sherbime te tjera transporti	120,000		

15	Bileta jashte vendit	390,000	123,600	
16	Dieta jashte vendit	640,000	231,387	
17	Dieta brenda vendit	576,000	324,000	
18	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve	72,000		
19	Shpenzime per mirembajtjen e pajisjeve te zyrave	60,000	25,000	
20	Qeramarrje ambientesh per aktivitete	420,000	295,000	
21	Shpenzime perkthimi	120,000	96,000	
22	Shpenzime per tatime e taksa	100,000	77,092	
	Totali me kod 91401AD	5,976,000	3,444,694	
	pakesohet nga akti normativ nr. 18059/51 dt 29.12.2025	2,000,000		
	Mbetje	3,976,000	3,444,694	87%

Realizimi i shpenzimeve operative (602) është në masën 72%, në shumën 3,444,694 lekë. Janë realizuar në masën gati 87% zërat karburant, shërbime operative, mirëmbajtje objekte, mirëmbajtje pajisje zyre, dieta etj

Si zëra të paprekur për këtë vit mbeten: shërbime tw tjera transporti në vlerën 120,000 lekë, , bileta jashtë vendit dhe dieta jashtë vendit të cilat zënë peshën 12% të llogarisë ekonomike 602 (shpenzime operative) në buxhetin e QPKMR-së.

INVESTIMET

Fondet për shpenzime kapitale në llogarinë ekonomike 231 për Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve janë me shkresë nr. 1060/2 prot, datë 17.04.2025 nga Ministria e Drejtësisë përkatësisht:

- 150,000 lekë, kodi 18AQ405, Blerje pajisje elektronike
- 150,000 lekë, kodi 18AQ406, Blerje pajisje zyre

Në datën 18.07.2025 me shkresën nr. 3129/3 prot nga Ministria e Drejtësisë , fondi prej 150,000 lekë në zërin pajisje zyre ka kaluar në zërin pajisje elektronike për shkak të nevojave më të mëdha në pajisje elektronike. Pajisjet elektronike shkojnë ne vlerën 300,000 lekë.

Nr	Emertimi i investimeve	Buxheti	Realizimi	%
01	Blerje pajisje elektronike për QPKMR	300,000	192,500	65

Fondet e investimeve janë realizuar në masën gati 65%.

DREJTOR

Klaudia Hasanllari

